



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

R A P O R T

PËR VETEUVALUIMIN E FAKULTETIT FILOZOFIK

2019/2020, 2020/2021, 2021/2022

Tetovë, 2025

PËRMBAJTJA

1. Qëllimi i procesit të evaluimit	3
2. Përshkrimi i Fakultetit	3
2.1. Historiku.....	3
2.2. Misioni.....	4
2.3. Strategjia e zhvillimit	4
3. Struktura organizative e Fakultetit.....	5
3.1. Organogrami.....	5
3.2. Programet studimore	6
3.3. Analiza e programeve studimore në Fakultetin Filozofik.....	7
4. Veprimtaria mësimore	7
5. Struktura e kuadrit mësimor-shkencor.....	8
6. Struktura e studentëve.....	11
6.1. Struktura e studentëve në studimet deridiplomike	11
6.2. Struktura e studentëve në studimet pasdiplomike (master).....	13
6.3. Struktura e studentëve në studimet e doktoraturës	15
7. Anketimi i studentëve	15
8. Veprimtaria shkencore dhe pjesëmarrja në projekte	18
9. Hapësirat dhe resurset materiale	19
10. SWOT analiza	20
11. Përfundime	22

1. QËLLIMI I PROCESIT TË VETEVALUIMIT

Qëllimi kryesor i këtij raporti është që të bëhet evaluimi i procesit mësimor në Fakultetin Filozofik në vitet akademike 2019/20, 2020/21 dhe 2021/22. Qëllimi i vetevaluimit ishte rrjedha dhe zhvillimi i procesit mësimor në këto vite akademike, dhe zhvillimet e përgjithshme nën Fakultetin Filozofik. Përfundimet, të cilët do të dalin nga ky raport i evaluimit, mund të shërbejnë si bazë për zhvillimin dhe ngritjen e mëtutjeshme të kualitetit të procesit mësimor –shkencor.

Evaluimi është realizuar nga komisioni i brendshëm për vetevaluim, i caktuar nga Këshilli i Fakulteti Filozofik në mbledhjen e mbajtur më 16.01.2020, dhe vendimi për formimin e anëtarëve të Komisionit me nr. 16-803/1, më datë; 26.10.2020.

Në procesin e evaluimit u përfshinë këto komponente:

- Vlerësimi i programeve studimore, ku përfshihet themelimi, përshkrimi dhe zhvillimi i programeve studimore,
- Struktura e kuadrit mësimor,
- Struktura e studentëve deridiplomike dhe master,
- Mënyra e realizimit të procesit mësimor,
- Struktura e kuadrit udhëheqës, administrativ dhe teknikë,
- Anketimi i studentëve,
- Veprimtaria shkencore dhe pjesëmarrja në projekte,
- Hapësirat dhe mjetet për realizimin e procesit mësimor.

Gjatë realizimit të procesit të evaluimit për përgatitje të këtij raportit, përveç anëtarëve të këtij komisioni, janë shfrytëzuar edhe profesorë, studentë si dhe administrata për marrjen dhe shfrytëzimin e të dhënave të nevojshme.

2. PËRSHKRIMI I FAKULTETIT

2.1. Historiku

Fakulteti Filozofik është njëri nga gjashtë fakultetet themeluese të Universitetit të Tetovës. Në vitin e parë akademik, në kuadër të Fakultetit Filozofik ka pasur dy programe studimore: Histori dhe Pedagogji, kurse nga viti akademik 1997/98, në kuadër të programit studimor Pedagogji, Fakulteti Filozofik funksionon me tre drejtime: parashkollor, klasor dhe profesional. Nga viti akademik 2001/02,

Fakulteti Filozofik u zgjerua me katër programe të reja studimore: Psikologji, Etnologji, Filozofi dhe Sociologji.

Me miratimin e Ligjit për themelimin e Universitetit të Tetovës, në vitin 2004, në kuadër të Universitetit të Tetovës u themeluan pesë fakultete, kurse Fakulteti Filozofik u emërua Fakulteti i Shkencave Humane dhe Arteve.

Në vitin 2008, me miratimin e Ligjit të ri, Fakulteti Filozofik u riformatua me pesë programe studimore: Histori, Pedagogji, Filozofi, Psikologji dhe Sociologji. Në vitin akademik 2009/2010, Fakultetit Filozofik iu shtua program studimor: Filologji orientale, kurse në vitin akademik 2013 edhe program studimor Edukim special dhe rehabilitim.

Në vitin akademik 2017/2018, nga Fakulteti Filozofik u shkëput Pedagogjia bashkë me ESR, nga të cilat u themelua Fakulteti Pedagogjik.

Në vitin akademik 2022/2023, në kuadër të Fakultetit Filozofik u akreditua programi i ri studimor: Punë sociale dhe mbrojtje sociale.

Të gjitha programet studimore në kuadër të Fakultetit Filozofik organizojnë studime katërvjeçare (240 ECTS) dhe studime njëvjeçare pasdiplomike (60 ECTS). Programet studimor të Historisë, Sociologjisë dhe Filologjisë orientale organizojnë edhe studime të doktoraturës.

2.2. Misioni

Programet studimore të Fakultetit Filozofik janë dizajnuar sipas principeve të sistemit të Bolonjës. Synohet që programet studimore t'i përshtaten dinamikës së reformave në sistemin arsimor në vend dhe përshtatjen kundrejt tendencave bashkëkohore në arsim.

Ky fakultet synon që studentët të arrijnë:

- Konkurrim në tregun akademik evropian;
- Profilizim përmes zhvillimit të kompetencave,;
- Programe të pranuar ndërkombëtarisht;
- Mundësi lëvizjeje akademike.

2.3. Strategjia e zhvillimit

Fakultetit Filozofik, në përputhje me misionin dhe vizionin e tij, ka të përcaktuar një numër të madh të objektivave strategjike, me synimin themelor që të rrisë cilësinë e mësimdhënies përmes qasjeve inovative në fushën e arsimit të lartë, shkencës dhe teknologjisë.

Strategjitë e zhvillimit e definojnë dhe orientojnë zhvillimin e këtij institucioni të lartë mësimor-shkencor, respektivisht i caktojnë mënyrat e arritjes, realizimit dhe 5 implementimit të qëllimeve të caktuara, njëherazi duke i marrë parasysh të gjitha nevojat, mundësitë dhe specifikat e mjedisit në të cilin operon.

Fakulteti Filozofik si komponentë përbërëse e Universitetit, paraqet një mjedis gjithëpërfshirës, dinamik dhe kompleks, që ngërthen në vete potencialet më të rëndësishme shkencore, hulumtuese dhe kreative të një shoqërie, dhe si i tillë tenton që, përmes strategjisë së zhvillimit dhe qëllimeve të vendosura strategjike, të përshtatura me standardet më të larta akademike, të zhvillojë të reflektojë dhe ndikojë në realizimin e proceseve në të gjitha sferat e shoqërisë.


Gjithashtu, në kuadër të punës së tij shkencore, përfshihen edhe projektet shkencore, si dhe një sërë hulumtimesh aplikative, përmes të cilave mundësohet zhvillimi i mendimit shkencor në vend dhe më gjerë.

3. STRUKTURA ORGANIZATIVE E FAKULTETIT

3.1. Organogrami

Organi më i lartë në Fakultetin Filozofik është Dekani, i ndjekur nga dy prodekanët: prodekani për arsim dhe prodekani për shkencë. Dekani merret me pjesët organizative të fakultetit, kurse dy prodekanët asistojnë në kryerjen e detyrave të ndryshme, bazuar në fushën e caktuar.

Drejtoria e Dekanatit përbëhet nga Dekani, prodekanët, koordinatori për ECTS, koordinatori për master, koordinatori për doktoratë dhe shefat e programeve studimore. Pjesë e rëndësishme e stafit të Dekanatit është dhe sekretari i fakultetit, që merret me detyrat e sferës juridike. Secili program studimor udhëhiqet nga një mësimdhënës nga katedra përkatëse. Të gjithë shefat e programeve studimore janë në bashkëpunim të ngushtë me drejtorinë e dekanatit. Për detyrat e tyre, ata i raportojnë Dekanit dhe prodekanëve për çështjet e ndryshme të programit përkatës të studimit.



Organogrami i Fakulteti Filozofik

3.2. Programet studimore

Në Fakultetin Filozofik ekzistojnë gjashtë programe studimore. Planprogramet janë organizuar konform prioriteteve kombëtare, tregut të punës dhe programeve studimore në rajon. Sipas deskriptorëve, të gjitha programet studimore janë konform sylabuseve dhe në përputhshmëri me rregulloren e kornizës kombëtare për kualifikimet në arsimin e lartë. Fakulteti Filozofik është i përfshirë në një projekt të organizuar nga Zyra për Menaxhimin e Cilësisë dhe Evaluimit, në përpjekje të analizës së programeve studimore. Konkretisht, analiza ishte e orientuar në identifikim të përputhshmërisë së qëllimeve të lëndëve me deskriptorët e programeve përkatëse, tregun e punës etj.

Tabela 1. Programet studimore në kuadër të Fakultetit Filozofik

Nr.	Programi studimor	Viti i themelimit
1.	Histori	1994
2.	Filozofi	2001
3.	Psikologji	2001
4.	Sociologji	2001
5.	Filologji orientale	2009
6.	Punë sociale dhe mbrojtje sociale	2021

3.3. Analiza e programeve studimore të Fakultetit Filozofik:

Në vitin akademik 2018/2019, në drejtim të implementimit të sugjerimeve nga evaluatorët e jashtëm, nga shefat e programeve studimore/komisioneve përkatëse, në bashkëpunim me Zyrën për Menaxhimin me Cilësinë dhe Evaluim, është realizuar evaluimi i programeve aktuale studimore të Fakultetit Filozofik. Procesi i evaluimit ka përfshirë:

- Vlerësimin e secilës lëndë mësimore e përfshirë në program, për çdo indikatorë, respektivisht;
 - a. lënda është në përputhshmëri me fushën e programit studimor, të kategorizuar në bazë të kualifikimeve ndërkombëtare të Fraskatit;
 - b. Në bazë të sylabusit, kompetencat që i krijon lënda janë jashtë kompetencave të përcaktuara me deskriptorët e pëgjithshëm të programit;
 - c. Duke u bazuar në rrjedhshmërinë kronologjike të lëndëve paraprake, lënda është e vendosur në semestrin e duhur;
 - ç. Ngarkesa që ju bëhet studentëve (aktiviteti i studentëve, punime, projekte...) tejkalon kornizën e paraparë të ngarkesës me fondin e orëve dhe kreditë me të cilat është akredituar lënda;
 - d. Duke marrë parasysh zhvillimet e fundit shkencore të fushës së programit studimor, lënda ka nevojë për azhurnim:
 - dh. Bazuar në sylabus, lënda nxit zhvillimin e shkathtësive të cilat janë të aplikueshme në treg të punës;
 - e. Duke u bazuar në fushën e programit studimor, statusi aktual i lëndës (obligative, zgjedhore, opcionale), duhet të ndryshohet.

4. VEPRIMTARIA MËSIMORE

Në gjashtë programe studimore të Fakultetit Filozofik, studimet zgjasin 4 vite (tetë semestra) dhe studentët gjithsej akumulojnë 240 (ECTS) kredi.

Programi studimor: Psikologji

Programi studimor i Psikologjisë është një nga të parat e Universitetit të Tetovës që nisi punën në vitin akademik 2001/2002, në kuadër të Fakultetit Filozofik. Studenti që diplomon, merr thirrjen *Psikolog i diplomuar*.

Programi studimor: Histori

Programi studimor i Historisë është themeluar në vitin akademik 1994/1995, në kuadër të Fakultetit Filozofik. Studenti që diplomon, merr thirrjen *Profesor i diplomuar i Historisë*.

Programi studimor: Sociologji

Programi studimor i Sociologjisë është themeluar në vitin 2001/2002, në kuadër të Fakultetit Filozofik. Studentët të cilët ndjekin këtë program studimor, marrin titullin *Profesor i diplomuar i Sociologjisë*.

Programi studimor: Filozofi me edukim qytetar

Programi studimor Filozofi me edukim qytetar nisi punën në vitin akademik 2001/2002. Studenti që diplomon, merr thirrjen *Profesor i diplomuar i Filozofisë*.

Programi studimor: Filologji orientale

Programi studimor Filologji orientale nisi punën në vitin akademik 2008/2009. Programi studimor i Filologjisë orientale ka të akredituara dy drejtime: Gjuhë dhe letërsi arabe dhe Gjuhë dhe letërsi turke. Studenti që diplomon, merr thirrjen *Profesor i diplomuar i gjuhës dhe letërsi arabe/turke*.

Programi studimor: Punë sociale dhe mbrojtje sociale

Programi studimor Punë sociale dhe mbrojtje sociale nisi punën në vitin akademik 2021/2022. Studenti që diplomon, merr thirrjen *Profesor i diplomuar i Punës sociale dhe mbrojtjes sociale*.

5. STRUKTURA E KUADRIT MËSIMOR-SHKENCOR

Në vitin akademik 2019/2020, në Fakultetin Filozofik janë angazhuar në procesin e mësimdhënies gjithsej 31 profesorë me status të rregullt edhe atë: 11 profesorë ordinarë, 9 profesorë inordinarë dhe 11 docentë. Struktura gjinore e profesorëve është 21 meshkuj dhe 10 femra.

Me qëllim të realizimit të suksesshëm, të procesit mësimor në këtë vit akademik, Fakulteti Filozofik ka angazhuar staf akademik part-time, gjithsej 6 mësimdhënës, prej tyre dy profesorë ordinarë dhe 4 docentë dhe 6 ligjërues (dr.sc). Struktura gjinore e mësimdhënësve të angazhuar është e përbërë vetëm nga meshkujt, 6 gjithsej.

Në vitin akademik 2019/20, në Fakultetin Filozofik kanë qenë të angazhuar dy bashkëpunëtorë të rregullt, një femër dhe një mashkull, ndërsa me kontratë janë angazhuar 28 bashkëpunëtorë, prej tyre 13 meshkuj dhe 15 femra.

Tabela 2. Numri i mësimdhënësve në Fakultetin Filozofik në vitin akademik 2019/2020

MËSIMDHËNËS							
Të rregullt	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Me kontratë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
<i>Ordinar</i>	9	2	11	<i>Ordinar</i>	2	/	2
<i>Inordinar</i>	8	1	9	<i>Inordinar</i>	/	/	/
<i>Docent</i>	4	7	11	<i>Docent</i>	4	/	4
Gjithsej	21	10	31	Gjithsej	6	/	6

Tabela 3. Numri i bashkëpunëtorëve në Fakultetin Filozofik në vitin akademik 2019/2020.

BASHKËPUNËTORË							
Të rregullt	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Me kontratë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Asistent	1	/	1	Asistent	13	15	28
Lektor	/	1	1	Lektor	/	/	/
Gjithsej	1	1	2	Gjithsej	13	15	28

Në vitin akademik 2020/2021, në Fakultetin Filozofik janë angazhuar në procesin e mësimdhënies gjithsej 28 profesorë me status të rregullt edhe atë: 9 profesorë ordinarë, 9 profesorë inordinar dhe 10 docentë. Struktura gjinore e profesorëve është 18 meshkuj dhe 10 femra.

Me qëllim të realizimit të suksesshëm të procesit mësimor në këtë vit akademik, Fakulteti Filozofik ka angazhuar staf akademik part-time gjithsej 8 mësimdhënës, prej tyre 1 profesor ordinar dhe 7 docentë. Struktura gjinore e mësimdhënësve të angazhuar është e përbërë nga 1 femër dhe 7 meshkuj.

Në vitin akademik 2020/21, në Fakultetin Filozofik kanë qenë të angazhuar 4 bashkëpunëtorë të rregullt, 2 femra dhe 2 meshkuj, ndërsa me kontratë janë angazhuar 23 bashkëpunëtorë prej tyre 13 meshkuj dhe 10 femra.

Tabela 4. Numri i mësimdhënësve në Fakultetin Filozofik në vitin akademik 2020/2021

MËSIMDHËNËS							
Të rregullt	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Me kontratë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
<i>Ordinar</i>	7	2	9	<i>Ordinar</i>	1	/	1
<i>Inordinar</i>	8	1	9	<i>Inordinar</i>	/	/	/
<i>Docent</i>	3	7	10	<i>Docent</i>	6	1	7
Gjithsej	18	10	28	Gjithsej	7	1	8

Tabela 5. Numri i bashkëpunëtorëve në Fakultetin Filozofik në vitin akademik 20120/2021

BASHKËPUNËTORË							
Të rregullt	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Me kontratë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Asistent	2	1	3	Asistent	13	10	23
Lektor	/	1	1	Lektor	/	/	/
Gjithsej	2	2	4	Gjithsej	13	10	23

Në vitin akademik 2021/2022 në Fakultetin Filozofik janë angazhuar në procesin e mësimdhënies gjithsej 27 profesorë me status të rregullt edhe atë: 14 profesorë ordinar, 7 profesorë inordinar dhe 6 docentë. Struktura gjinore e profesorëve është 17 meshkuj dhe 10 femra.

Me qëllim të realizimit të suksesshëm të procesit mësimor në këtë vit akademik, Fakulteti Filozofik ka angazhuar staf akademik part-time gjithsej 12 mësimdhënës, prej tyre 1 profesor ordinar, 1 profesor inordinar dhe 10 docentë. Struktura gjinore e mësimdhënësve të angazhuar është e përbërë nga 10 meshkuj dhe 2 femra.

Në vitin akademik 2021/22, në Fakultetin Filozofik kanë qenë të angazhuar 4 bashkëpunëtorë të rregullt, 2 femra dhe 2 meshkuj, ndërsa me kontratë janë angazhuar 22 bashkëpunëtorë prej tyre 11 meshkuj dhe 11 femra.

Tabela 6. Numri i mësimdhënësve në Fakultetin Filozofik në vitin akademik 2021/2022.

MËSIMDHËNËS							
Të rregullt	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Me kontratë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
<i>Ordinar</i>	12	2	14	<i>Ordinar</i>	1	/	1
<i>Inordinar</i>	4	3	7	<i>Inordinar</i>	1	/	1
<i>Docent</i>	1	5	6	<i>Docent</i>	8	2	10
Gjithsej	17	10	27	Gjithsej	10	2	12

Tabela 7. Numri i bashkëpunëtorëve në Fakultetin Filozofik në vitin akademik 2021/2022.

BASHKËPUNËTORË							
Të rregullt	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Me kontratë	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Asistent	2	1	3	Asistent	11	11	22
Lektor	/	1	1	Lektor	/	/	/
Gjithsej	2	2	4	Gjithsej	11	11	22

6. STRUKTURA E STUDENTËVE

6.1. Struktura e studentëve në studimet deridiplomike

Trendi i numrit të studentëve në vitet paraprake ka qenë në rritje, por për vitet akademike që janë pjesë e këtij raporti, siç e shohim në tabelat e mëposhtme, është në rënie. Rënia e numrit të studentëve varet nga shumë faktorë, si nataliteti, shpërngulja, etj.

Në vitin akademik 2019/2020 në studimet deridiplomike numri i përgjithshëm i studentëve që kanë ndjekur studimet në Fakultetin Filozofik është 532 studentë, edhe atë: 271 në Psikologji, 62 në Histori, 97 në Sociologji, 75 në Filologji orientale dhe 27 në Filozofi.

Në vitin akademik 2020/2021 në studimet deridiplomike numri i përgjithshëm i studentëve që kanë ndjekur studimet në Fakultetin Filozofik është 463 studentë, edhe atë: 273 në Psikologji, 43 në Histori, 82 në Sociologji, 57 në Filologji orientale dhe 8 në Filozofi.

Në vitin akademik 2021/2021 në studimet deridiplomike numri i përgjithshëm i studentëve që kanë ndjekur studimet në Fakultetin Filozofik është 393 studentë, edhe atë: 248 në Psikologji, 27 në Histori, 72 në Sociologji, 43 në Filologji orientale dhe 3 në Filozofi.

Rënia e numrit të përgjithshëm është si rezultat i diplomimit të studentëve dhe regjistrimit çdo vit e më pak për herë të parë. Programi studimor Histori ka rënie me të madhe të numrit të përgjithshëm rreth 57.5% (nga 62 në vitin 2019/2020 në 27 në vitin 2021/2022).

Tabela 8. Numri i përgjithshëm i studentëve në vitin akademik 2019/2020

Nr.	Programi studimor	Të rregullt	Me korrespondencë	Gjithsej
1.	Psikologji	271	/	271
2.	Histori	58	4	62
3.	Filozofi	25	2	27
4.	Sociologji	81	16	97
5.	Filologji orientale	66	9	75

Gjithsej	501	31	532
-----------------	------------	-----------	------------

Tabela 9. Numri i përgjithshëm i studentëve në vitin akademik 2020/2021

Nr.	Programi studimor	Të rregullt	Me korrespondencë	Gjithsej
1.	Psikologji	273	/	273
2.	Histori	20	4	43
3.	Filozofi	5	/	8
4.	Sociologji	18	7	82
5.	Filologji orientale	25	/	57
Gjithsej		341	11	463

Tabela 10. Numri i përgjithshëm i studentëve në vitin akademik 2020/2021

Nr.	Programi studimor	Të rregullt	Me korrespondencë	Gjithsej
1.	Psikologji	248	/	248
2.	Histori	25	2	27
3.	Filozofi	3	/	3
4.	Sociologji	63	9	72
5.	Filologji orientale	39	4	43
Gjithsej		378	15	393

Në vitin akademik 2019/2020, në Fakultetin Filozofik, në ciklin e parë të studimeve në programet studimore, në vitin e parë janë regjistruar gjithsej 89 studentë, edhe atë: 54 në programin studimor Psikologji, 11 në programin studimor Histori, 11 në programin studimor Sociologji, 8 studentë në programin studimor Filologji orientale, ndërsa në programin studimor Filozofi- 5 studentë.

Në vitin akademik 2020/2021, në studimet deridiplomike në Fakultetin Filozofik, për herë të parë janë regjistruar 70 studentë, edhe atë: 47 në Psikologji, 6 në Sociologji, 11 në Filologji orientale, 6 në Histori, kurse programi studimor Filozofi, në vitin e parë, dytë dhe të tretë, nuk ka studentë të regjistruar.

Në vitin akademik 2021/2022, në studimet deridiplomike në Fakultetin Filozofik, për herë të parë janë regjistruar 50 studentë, edhe atë: 30 në Psikologji, 10 në Sociologji, 7 në Filologji orientale, 3 në Histori, kurse në programin studimor Filozofi me edukim qytetar nuk ka pasur studentë të regjistruar.

6.2. Struktura e studentëve në studimet pasdiplomike (master)

Në Fakultetin Filozofik janë të akredituar 11 drejtime në kuadër të 5 programeve studimore, edhe atë: HISTORI (Historia e mesjetës, Historia e kohës së re, Historia e kohës bashkëkohore), PSIKOLOGJI (Pedagogjike, Klinike, Arsimore- 2019/2020, kurse nga viti 2020/2021- Psikologji për këshillim dhe karrierë, Psikologji klinike dhe këshilluese, Psikologji arsimore dhe edukative), SOCIOLOGJI (Shoqëria dhe problemet globale, Studime kulturologjike), FILOZOFI (Filozofi bashkëkohore), dhe FILOLOGJI ORIENTALE (Gjuhë dhe letërsi arabe, Gjuhë dhe letërsi turke).

Në vitin akademik 2019/20, në Fakultetin Filozofik janë regjistruar gjithsej 37 studentë, edhe atë 18 në programin studimor Psikologji, 10 në programin studimor Histori, 4 studentë në programin studimor Filologji orientale, në programin studimor Sociologji 5 studentë, ndërsa në programin studimor Filozofi nuk ka pasur student të regjistruar.

Tabela 11. Numri i përgjithshëm i studentëve në vitin akademik 2019/2020.

Nr.	Programi studimor	Numri i studentëve
1.	HISTORI	10
	Historia e mesjetës	/
	Historia e kohës së re	3
	Historia e kohës bashkëkohore	7
2.	PSIKOLOGJI	18
	Psikologji pedagogjike	8
	Psikologji organizative	1
	Psikologji klinike	9
3.	SOCIOLOGJI	6
	Shoqëria dhe problemet globale	6
	Studime kulturologjike	/
4.	FILOZOFI	/
	Filozofi bashkëkohore	/
5.	FILOLOGJI ORIENTALE	3
	Gjuhë dhe letërsi arabe	1
	Gjuhë dhe letërsi turke	2
	Gjithsej	37

Në vitin akademik 2020/21, në Fakultetin Filozofik janë regjistruar gjithsej 26 studentë, edhe atë 14 në programin studimor Psikologji, 6 në programin studimor Histori, 8 studentë në programin studimor Filologji orientale, në programin studimor Sociologji 1 studentë, ndërsa në programin studimor Filozofi nuk ka pasur student të regjistruar.

Tabela 12. Numri i përgjithshëm i studentëve në vitin akademik 2020/2021

Nr.	Programi studimor	Numri i studentëve
1.	HISTORI	3
	Historia e mesjetës	/
	Historia e kohës së re	2
	Historia e kohës bashkëkohore	1
2.	PSIKOLOGJI	14
	Psikologji pedagogjike	3
	Psikologji organizative	2
	Psikologji klinike	9
3.	SOCIOLOGJI	1
	Shoqëria dhe problemet globale	/
	Studime kulturologjike	1
4.	FILOZOFI	/
	Filozofi bashkëkohore	/
5.	FILOLOGJI ORIENTALE	8
	Gjuhë dhe letërsi arabe	4
	Gjuhë dhe letërsi turke	4
	Gjithsej	26

Në vitin akademik 2021/22, në Fakultetin Filozofik janë regjistruar gjithsej 48 studentë, edhe atë 33 në programin studimor Psikologji, 6 në programin studimor Histori, 6 studentë në programin studimor Filologji orientale, në programin studimor Sociologji 2 studentë, në programin studimor Filozofi 1 student të regjistruar.

Rritja e numrit të studentëve në ciklin e dytë është si rezultat i rritjes së numrit të studentëve në programin studimor Psikologji, pas akreditimit të tri drejtimeve, të cilat mundësojnë studime njëvjeçare dhe dyvjeçare, si dhe intersimit të studentëve që janë shtetas të huaj, në rradhë të parë nga Republika e Kosovës.

Tabela 13. Numri i përgjithshëm i studentëve në vitin akademik 2021/2022.

Nr.	Programi studimor	Numri i studentëve
1.	HISTORI	6
	Historia e mesjetës	/
	Historia e kohës së re	3
	Historia e kohës bashkëkohore	3

2.	PSIKOLOGJI	33
	Psikologji për këshillim dhe karrierë	1
	Psikologji klinike dhe këshilluese	24
	Psikologji arsimore dhe edukative	8
3.	SOCIOLOGJI	2
	Shoqëria dhe problemet globale	2
	Studime kulturologjike	/
4.	FILOZOFI	1
	Filozofi bashkëkohore	1
5.	FILOLOGJI ORIENTALE	6
	Gjuhë dhe letërsi arabe	5
	Gjuhë dhe letërsi turke	1
Gjithsej		48

6.3. Struktura e studentëve në studimet e doktoraturës


Nga viti akademik 2016/2017, në Fakultetin Filozofik të Universitetit të Tetovës zhvillohen studime të ciklit të tretë, studime trevjeçare doktorale. Fillimisht studentë janë regjistruar në programin studimor Histori, në dy drejtime. Në vitin akademik 2018/2019, studimet e shkallës së tretë (doktoraturës) kanë filluar që të zhvillohen edhe në dy programe studimore, në Sociologji dhe Filologji orientale.

Në vitin akademik 2021/2022, si rezultat i akreditimit të dy mentorëve në doktoraturë, në Fakultetin Filozofik janë regjistruar 6 studentë, 3 në programin studimor Filologji orientale dhe 3 në Sociologji, moduli: Socio-politik. Për nga struktura gjinore, nga 6 studentët e regjistruar, 5 janë meshkuj dhe 1 femër. Tre nga studentët të regjistruar janë shtetas të huaj.

7. ANKETIMI I STUDENTËVE

Vlerësim mbi procesin mësimor kanë realizuar edhe studentët e Fakultetit Filozofik. Studentët janë përgjigjur në pyetësorë online për procesin e mbarëvajtjes dhe cilësisë së procesit mësimor, edhe atë veçmas për ligjërata dhe veçmas për ushtrime. Në çdo pyetje, studentët janë përgjigjur se sa pajtohen nëse një dukuri e caktuar ka qenë prezente gjatë procesit mësimor, në shkallë prej 1, që nënkupton se dukuria e caktuar nuk ka qenë aspak prezente, deri në 5, ku dukuria e caktuar ka qenë plotësisht prezente.


Studentët e Fakultetit Filozofik gjithsej kanë dhënë 182 vlerësime, nga të tre programet studimore të fakultetit, përfshirë gjithë vitet studimore. Në nivel të fakultetit, në të gjithë indikatorët studentët kanë vlerësuar pozitivisht realizimin e procesit mësimor. Studentët të cilët i janë nënshtruar provimeve në lëndët e vlerësuara, plotësisht pajtohen se testimi në lëndët e evaluuara është realizuar nga materiali i ofruar dhe ligjëruar ($M = 4.64$). Si vijim, studentët plotësisht pajtohen se në lëndët të cilat i kanë vlerësuar, fillimi dhe përfundimi i ligjëratave ($M = 4.35$) dhe ushtrimeve ($M = 4.20$) është i saktë sipas orarit të planifikuar (grafikoni 1). Vlerësim i ngjashëm shprehet edhe për lidhshmërinë e materialit për përdorim praktik gjatë orëve të ligjëratave ($M = 4.31$) dhe orën e ushtrimeve ($M=4.11$). Mësimdhënësit gjatë orëve të ligjëratave, kanë qenë të qartë lidhur me materialin e prezantuar ($M=4.34$); gjatë ushtrimeve, niveli i qartësisë është shprehur me ($M=4.08$). Tendencë për vlerësim më të lartë paraqitet lidhur me nivelin e informimit të studentëve për realizimin e lëndëve gjatë ligjëratave ($M=4.57$) kurse për ushtrimet niveli i informimit shprehet me koeficientin ($M=4.37$).



Grafikoni 1. Vlerësimi i procesit mësimor në Fakultetin Filozofik


Në Programin studimor Psikologji, në të gjithë indikatorët, studentët kanë vlerësuar pozitivisht realizimin e procesit mësimor. Studentët të cilët i janë nënshtruar provimeve në lëndët e vlerësuara, pajtohen se testimi në lëndët e evaluuara është realizuar plotësisht nga materiali i ofruar dhe ligjëruar ($M = 4.80$). Si vijim, studentët plotësisht pajtohen se, në lëndët të cilat i kanë vlerësuar, fillimi dhe përfundimi i ligjëratave ($M = 4.69$) dhe ushtrimeve ($M = 4.47$) është i saktë sipas orarit të planifikuar (grafikoni 2). Vlerësim i ngjashëm shprehet edhe për lidhshmërinë e materialit për përdorim praktik gjatë orëve të ligjëratave ($M = 4.48$) dhe orën e ushtrimeve ($M=4.25$). Mësimdhënësit, gjatë orëve të ligjëratave, kanë qenë të qartë lidhur me materialin e prezantuar ($M=4.53$), gjatë ushtrimeve, niveli i qartësisë është shprehur me ($M=4.22$). Tendencë për vlerësim të lartë paraqitet lidhur me nivelin e

informimit të studentëve për realizimin e lëndëve gjatë ligjëratave ($M=4.59$), kurse për ushtrimet, niveli i informimit është po ashtu pozitiv, por me një tendencë të uljes krahasuar me ligjëratat ($M=4.37$).



Grafikoni 2. Vlerësimi i procesit mësimor në Programin studimor Psikologji

Në Programin studimor Sociologji, studentët të cilët i janë nënshtruar provimeve në lëndët e vlerësuara, pajtohen se testimi në lëndët e evaluuara është realizuar nga materiali i ofruar dhe ligjëruar ($M = 4.12$). Si vijim, studentët pajtohen se në lëndët të cilat i kanë vlerësuar, fillimi dhe përfundimi i ligjëratave ($M = 3.26$) dhe ushtrimeve ($M = 3.19$) është mesatarisht i saktë sipas orarit të planifikuar (grafikoni 3). Vlerësim i ngjashëm shprehet edhe për lidhshmërinë e materialit për përdorim praktik gjatë orëve të ligjëratave, me një tendencë të rritjes krahasuar me indikatorët paraprak ($M = 3.65$), dhe orët e ushtrimeve ($M=3.44$). Mësimdhënësit, gjatë orëve të ligjëratave, kanë qenë të qartë lidhur me materialin e prezantuar ($M=3.72$), gjatë ushtrimeve, niveli i qartësisë është shprehur me ($M=3.39$). Tendencë për vlerësim të lartë paraqitet lidhur me nivelin e informimit të studentëve për realizimin e lëndëve gjatë ligjëratave ($M=4.49$) kurse për ushtrimet niveli i informimit është po ashtu pozitiv, por me një tendencë të uljes krahasuar me ligjëratat ($M=4.35$).



Grafikoni 3. Vlerësimi i procesit mësimor në Programin studimor Sociologji

8. VEPRIMTARIA SHKENCORE DHE PJESËMARRJA NË PROJEKTE

Stafi akademik i Fakultetit Filozofik ka qënë pjesëmarrës nëpër konferenca, simpoziume, projekte, publikime, monografi dhe shkrime në gazeta ditore të shtypura dhe atyre online, si brenda vendit ashtu edhe jashta tij.

Gjatë viteve akademike 2019/2020, 2020/2021 dhe 2021/2022, në bazë të të dhënave të Raportit vjetor të Fakultetit Filozofik, mësimdhenësit dhe bashkëpunëtorët në marrëdhënie të rregullt pune në Fakultetin Filozofik kanë botuar 30 libra, 80 punime shkencore dhe kanë marrë pjesë në 100 konferenca, simpoziume dhe tubime shkencore. Duke i krahasuar këto të dhëna me biografitë dhe bibliografitë e mësimdhenësve të Fakultetit Filozofik, mund të konstatojmë se shumica prej tyre nuk i kanë përditësuar veprimtaritë e tyre kërkimore dhe hulumtuese.

Mësimdhenësit dhe bashkëpunëtorët në marrëdhënie të rregullt pune në Fakultetin Filozofik, gjatë viteve akademike 2019/2020, 2020/2021 dhe 2021/2022, kanë marrë pjesë në 100 konferenca, simpoziume dhe tubime shkencore, gjysma prej të cilave jashtë vendit.

Dominojnë pjesëmarrjet në konferencat e organizuara nga Fakulteti Filozofik (Konferenca VII dhe VIII) dhe konferencat e organizuara nga Universiteti i Tetovës (Seminari Ndërkombëtar i Albanologjisë, konferencat vjetore të fakulteteve, etj). Numrin më të madh të konferencave jashtë vendit e përbejnë organizimet shkencore në Prishtinë dhe Tiranë. Numri më i madh i pjesëmarrësve është nga mësimdhenësit e psikologjisë, të ndjekur nga mësimdhenësit e historisë.

Në fund, ritheksojmë se shumica e mësimeve dhe bashkëpunëtorëve nuk i kanë përditësuar të dhënat dhe për rrjedhojë nuk kemi një pasqyrë të saktë për veprimtarinë e tyre kërkimore dhe hulumtuese gjatë këtyre tri viteve.

Nga viti akademik 2013/2014, Fakulteti Filozofik organizon Konferencë ndërkombëtare me një temë bosht dhe nëntema nga të gjitha programet studimore. Kjo Konferencë, për shkak të pandemisë Covid-19, nuk u organizua gjatë vitit 2020 dhe 2021.

Nga viti 2014, në kuadër të Fakultetit Filozofik botohet Revista shkencore ndërkombëtare “*Philosophica*”. Gjatë viteve akademike 2019/2020, 2020/2021, 2021/22 janë botuar tre vëllime dhe gjashtë numra, në gjuhën angleze, dhe lexuesit kanë qasje online. Revista shkencore ndërkombëtare “*Philosophica*” është indeksuar në Google Scholar, IndexCopernicus International, CEEOL dhe EBSCO.

9. HAPËSIRAT DHE RESURSET MATERIALE

Fakulteti Filozofik ka në dispozicion salla mësimore, amfiteatër, kabinete, leximore dhe bibliotekë. Numri i sallave mësimore në total është 8, amfiteatra 2, 1 bibliotekë, 1 leximore, ndërsa kabinete gjithsej 18 në numër. Fakulteti Filozofik përmes bibliotekës së tij, e cila është e përbashkët me Fakultetin Pedagogjik dhe Fakultetin Filologjik, u ofron studentëve dhe stafit akademik mbi 2500 tituj librash, e cila vazhdimisht pasurohet edhe me tituj të rinjë librash.

Tabela 14. Hapësirat dhe resurset materiale në Fakultetin Filozofik

	Hapësira të Fakultetit Filozofik	Numri	m ²
1	Salla mësimore	8	478.01 m ²
2	Amfiteatër	2	346.84 m ²
3	Kabinete	18	342.87 m ²
4	Zyrë administrative në Dekanat	4	60.29 m ²
5	Zyra të shërbimit administrativ	3	152.87 m ²
6	Bibliotekë	1	41.79 m ²
7	Leximore	1	41.15 m ²
8	Korridore	2	465.50 m ²
Gjithsej		27	1929,32 m²
	Pajisje të stafit mësimor të Fakultetit Filozofik	Numri	
1	Kompjuterë për stafin mësimor	45	
2	Printerë	22	

3	Video projektorë	10
Gjithsej		77
Pajisje të administratës		
1	Kompjuterë	11
2	Printerë	7
Gjithsej		18

10. SWOT ANALIZA

SWOT analiza, si një model themelor i planifikimit strategjik, paraqet një kornizë të identifikimit dhe analizës së faktorëve të brendshëm (fuqive dhe dobësive) dhe faktorëve të jashtëm (mundësive dhe kërcënimeve) që ndikojnë në funksionimin e suksesshëm të një institucioni. Identifikimi i komponentëve të jashtëm dhe të brendshëm të SWOT analizës ka një rëndësi të veçantë për mbarëvajtjen e përgjithshme të procesit mësimor-shkencor dhe sukseseve që planifikohen të arrihen në të ardhmen.

Në vazhdim, në kuadër të SWOT analizës në Fakultetin Filozofik, janë paraqitur faktorët e jashtëm dhe të brendshëm që ndikojnë në mbarëvajtjen e procesit mësimor- shkencor.

Strengths: Fuqitë	Opportunities: Mundësitë
<ol style="list-style-type: none"> Ofrim i programeve cilësore të arsimit të lartë dhe shkencës; Përmirësim i mësimdhënies përmes përdorimit të metodologjive të reja; Kompatibilitet i programeve studimore me programet e Universiteteve tjera në rajon dhe me gjerë; Ofrim i programeve të reja studimore në përputhshmëri me kërkesat e tregut të punës; Infrastrukturë e përshtatshme dhe klimë pozitive dhe kooperuese; Avancim i vazhdueshëm i stafit akademik; 	<ol style="list-style-type: none"> Rritje e rezultateve kërkimore – shkencore të stafit akademik në revista konkurruese të pranuar ndërkombëtarisht; Rritja e bashkëpunimit në nivel vendor dhe ndërkombëtar me sektorin privat dhe grupe tjera të interesit; Realizim i metodave të reja të realizimit të mësimit (mësim nga largësia); Interesimi i lartë i studentëve shtetas të huaj për studime në magistraturë dhe doktoraturë; Hapja e programeve të reja studimore, duke

<p>7. Komunikim efektiv pedagog-student;</p> <p>8. Pjesëmarrja e studentëve dhe mësimdhënësve në programet Erasmus dhe Mevlana;</p> <p>9. Efikasiteti i menaxhmentit të Fakultetit Filozofik dhe shërbimit studentor;</p> <p>10. Botimi dhe cilësia e revistës shkencore të Fakultetit “Philosophica” (vazhdimësia dhe indeksimi);</p>	<p>përfshirë edhe studimet master dhe të doktoraturës;</p> <p>6. Krijimi i një fondi të bursave për hulumtime shkencore afatshkurtër jashtë vendit;</p>
<p>Weaknesses: Dobësitë</p>	<p>Threats: Kërcënimet</p>
<p>1. Mungesë e kualifikimit dhe trajnimit të vazhdueshëm të stafit akademik;</p> <p>2. Mungesë e rrjetit Alumni për ndjekjen e zhvillimit profesional të studentëve të diplomuar;</p> <p>3. Shfrytëzim i dispozitave ligjore dhe institucionale për zgjerim të bashkëpunimit me sektorin privat dhe institucionet shtetërore;</p> <p>4. Mungesa e mjeteve financiare për avancimin e projekteve mësimorëshkencore;</p> <p>5. Interesim jo i mjaftueshëm nga ana sektorit privat dhe institucioneve shtetërore për shfrytëzimin e potencialit intelektual;</p> <p>6. Mungesa e më shumë sallave leximore dhe funksionimi i tyre me orar me të zgjatur;</p> <p>7. Mungesa e ciklit të tretë në disa programe studimore të Fakultetit Filozofik.</p>	<p>1. Ndryshime të shpeshta të ligjeve dhe strategjive për punësimin e studentëve nga faktorë të jashtëm;</p> <p>2. Shkallë e lartë e migracionit dhe gjendja e vështirë ekonomike në shoqëri ka ndikuar në uljen e numrit të studentëve;</p> <p>3. Disproporcioni i madh i numrit të studentëve të ciklit të parë të disa programe studimore;</p> <p>4. Numri i pamjaftueshëm i sallave ku zhvillohet procesi mësimor;</p> <p>5. Mungesa e aktiviteteve dhe punës praktike jashtë Universitetit;</p> <p>6. Disproporcioni i madh midis bashkëpunëtorëve me marrëdhënie pune të rregullt dhe me kontratë pune;</p> <p>7. Disproporcioni i madh i numrit të studentëve të ciklit të parë të disa programe studimore;</p> <p>8. Mosplotësimi/azhurimi i veprimtarisë shkencore nga ana e stafit në web faqen e universitetit.</p>

11. PËRFUNDIME

Brënda këtij Raporti të vetevaluimit janë paraqitur aktivitetet të cilat janë realizuar në kuadër të programeve studimore të Fakultetit Filozofik në Universitetin e Tetovës, gjatë viteve akademike 2019/2020, 2020/2021 dhe 2021/2022, në veprimtarinë mësimore-shkencore, kërkimore-shkencore dhe veprimtarinë organizative.

Veprimtaria mësimore në Fakultetin Filozofik gjatë gjatë viteve akademike 2019/2020, 2020/2021 dhe 2021/2022, është realizuar në tre cikle studimore. Në këtë periudhë trevjeçare, duke filluar nga semestri veror i vitit 2019/2020, përkatësisht nga data 9 mars 2020, thujase të gjitha aktivitetet e Fakultetit Filozofik janë përshtatur me situatën e krijuar të pandemisë Covid-19, që nënkuptonte vazhdimin e ligjeratave, ushtrimeve në distancë, po ashtu edhe vlerësimin e njohurive. Udhëheqësia e Fakultetit Filozofik, mësimdhenësit dhe administrata në kushte pandemie me sukses dhe në kohë kanë kryer detyrat.

Kuadri arsimor dhe administrativ, si dhe studentët e Fakultetit Filozofik janë të angazhuar dhe janë zotuar për realizimin e suksesshëm të qëllimeve të këtij fakulteti. Raporti i evaluimit, përmes analizave dhe fakteve të paraqitura, pasqyron gjendjen reale të fakultetit dhe programeve studimore, duke përfshirë të gjitha aspektet e funksionimit të tyre, avancimin dhe të arriturat, si dhe anët e forta por edhe të dobëta për të cilat do të ndërmerren masa për tejkalimin e tyre. Në këtë mënyrë, do të kontribuohet në realizimin e plotë dhe cilësor të procesit mësimor-shkencor në përgjithësi.

Programet studimore në kuadër të këtij fakulteti në vazhdimësi zhvillohen dhe avancohen që të jenë në hap me kërkesat dhe zhvillimet e reja në tregun e punës. Kuadri mësimor i plotëson të gjitha parakushtet në raport me profesionalizmin e tyre në realizimin e procesit mësimor-shkencor. Udhëheqësia e këtij fakulteti në mënyrë permanente ndjek të gjitha zhvillimet dhe inovacionet në arsimin e lartë dhe përkushtohet në etablimin e standardeve të larta për krijimin e një modeli për zhvillim të qëndrueshëm që do të mundësojë arsimin cilësor për studentët e tij, si dhe një mjedis produktiv dhe motivues për të punësuarit.

Si tendencë kryesore e tij në të ardhmen ngel përkushtimi i tij që studentëve t'ju mundësojë një bazë solide të njohurive, shkathtësive dhe shprehive të punës, përmes së cilave do të arrijnë jo vetëm zhvillimin dhe avancimin e tyre profesional, por edhe avancimin e shoqërisë në të cilën jetojnë.

Tetovë, më 15. V. 2024